

Marrëdhëniet mes Kosovës e Serbisë: Asociacioni i komunave me shumicë serbe dhe dialogu

Hyrje

Këshilli për Qeverisje Inkluzive (CIG) ka organizuar më 13-14 dhjetor të vitit 2014, në Budvë të Malit të Zi, një tryezë të rrumbullakët për zyrtarë qeveritar, përfaqësues të partive politike dhe anëtarë të shoqërisë civile nga Kosova e Serbia. Diskutimi ka adresuar krijimin e Asociacionit/Komunitetit të komunave me shumicë serbe (më tej referuar si Asociacion) në Kosovë, dhe dialogun mes Prishtinës e Beogradit. Pjesëmarrësit kanë qenë përfaqësues të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lëvizjes Vetëvendosje (VV), Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, dhe qeverisë së Kosovës dhe zyrës së presidentes; dhe përfaqësues të Partisë Progresive të Serbisë (SNS), Partisë Socialiste të Serbisë (SPS), Partisë Social-Demokrate (SDS) dhe qeverisë së Serbisë. Në takim kanë marrë pjesë poashtu një numër analistësh nga Kosova e Serbia.

Tryeza e rrumbullakët është pjesë e projektit për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës e Serbisë, të përkrahur nga Departamenti Federal për Punë të Jashtme i Zvicrës.

Dita e parë e diskutimit është fokusuar në krijimin e Asociacionit të dhjetë komunave me shumicë serbe. Pjesëmarrësit kanë listuar një numër pengesash të cilat janë duke vonuar krijimin e Asociacionit. Shumë folës nga Kosova e kanë bërë përgjegjës Beogradin dhe institucionet e mbetura paralele në veri për vonesat në implementimin e marrëveshjes së Brukselit, pjesë e së cilës është edhe Asociacioni. Folësit serbë kanë thënë se vonesa ka ndodhur kryesisht për shkak se Prishtinës i janë dashur gjashtë muaj për të formuar qeverinë e re. Lista Srpska është pjesë e koalicionit qeverisës, dhe mban dy ministri dhe një post të zëvendëskryeministrit, por ka kushtëzuar hyrjen në këtë koalicion me disa kushte, ku njëra prej tyre është që Asociacioni të formohet brenda pesë muajve të parë të qeverisjes. Shumë prej pjesëmarrësve kanë thënë se Lista Srpska duhet të marrë mbi vete më shumë përgjegjësi, pasi që tani udhëheq Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Poashtu është përmendur nevoja për më shumë komunikim mes institucioneve qendrore të Kosovës dhe komunave me shumicë serbe, e sidomos të atyre në veri.

Dita e dytë është fokusuar më shumë në të ardhmen e dialogut. Shumë folës kanë thënë se është e vështirë të vazhdohet dialogu dhe të arrihen marrëveshje të reja, për aq kohë sa ato të vjetrat nuk implementohen. Një numër i përfaqësuesve nga Kosova kanë qenë kundër vazhdimit të dialogut në këtë format, duke thënë se nuk është në interes të Kosovës, dhe se Kosova nuk duhet të diskutojë me fqinjët çështjet e saja të brendshme. Ata kanë thënë se dialogu për çështje të tilla është i nevojshëm me serbët e Kosovës, e jo me Beogradin.

Në vazhdim është një përmbledhje e këtij diskutimi. Me qëllim të nxitjes së diskutimit të hapur, diskutimet nuk u janë atribuar folësve të veçantë. Pjesëmarrësit kanë marrë pjesë në këtë tryezë

të rrumbullakët në kapacitetet e tyre personale, dhe qëndrimet e tyre nuk reflektojnë domosdoshmërisht qëndrimet e organizatave të cilat ata i përfaqësojnë.

Krijimi i Asociacionit të komunave me shumicë serbe

Ka ekzistuar konsensus mes pjesëmarrësve se marrëveshja e Brukselit nuk është duke u implementuar sipas afateve kohore të parapara. Por përderisa pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës e kanë fajësuar Beogradin, kryetarët e rinjë të komunave dhe institucionet e mbetura paralele në veri të Kosovës, siç janë të ashtuqujturat mbrojtja civile dhe organet “e përkohshme” ekzekutive komunale serbe, folësit serbë kanë thënë se Prishtina e ka bllokuar procesin duke mos mos qenë e gatshme të bëjë kompromiset e nevojshme për të shkuar më tej me implementimin. Asociacioni ishte pritur të krijohet pas krijimit të komunave në veri. Një vit pas zgjedhjeve, administratat komunale nuk janë ende funksionale, dhe nuk ekziston ende as statuti për Asociacionin.

Megjithate, një zyrtar i Kosovës ka thënë se ka përparim në këtë fushë. Ai ka thënë se procesi i krijimit të komunave është duke vazhduar, është arritur pajtimi për buxhetet komunale, është rritur bashkëpunimi mes kryetarëve të komunave dhe institucioneve të Kosovës, dhe janë përgatitur edhe një numër projektesh. Ai ka shprehur pakënaqësinë e tij me kryetarët e rinjë të komunave në veri, pasi që ata në mënyrë të vazhdueshme shkelin ligjet e Kosovës dhe largojnë nga puna në mënyrë arbitrare shumë të punësuar në administratë, dhe i zëvendësojnë ata me të tjerë, pa i rrespektuar proceset. Krijimi i administratës është i ngadalshëm. Komunitat nuk janë duke funksionuar dhe ende nuk ofrojnë shërbime. Për shkak të kësaj, ai ka shtuar se nevojitet më shumë dialog rreth implementimit. Krijimi i Asociacionit nuk do të duhet të ishte shumë i vështirë. Komunitat formojnë Asociacionin, por komunitat duhen së pari të jenë funksionale në mënyrë që të formojnë Asociacionin. Folësi poashtu ka thënë se fondi zhvillimor për veriun, i krijuar si pjesë e marrëveshjes së Brukselit, ka mbledhur rreth 3 milion euro, por komunitat nuk mund t'i shfrytëzojnë këto fonde përderisa të mos jenë vetë plotësisht funksionale. Për më shumë, qeveria e Kosovës u ka ofruar 48 milion euro katër komunave në veri. Komunitat i kanë refuzuar fondet për “arsye politike”, ka thënë ky folës. Shpenzimet më të mëdha komunale janë në arsim dhe shëndetësi. Megjithate, autoritetet komunale konsiderojnë se përgjegjësia për këta dy sektorë do të duhet të binte mbi Asociacionin, e jo mbi komunitat. Si rrjedhojë e kësaj, buxheti i tanishëm i adoptuar nga katër komunitat është 7 milion euro. Vizioni i Asociacionit si “shtresa e tretë e qerisë” është duke u refuzuar kategorikisht nga autoritetet e Kosovës, ka thënë një folës tjetër.

Një folës serb ka thënë se Asociacioni do të duhet të ishte organ qeveritar me kompetenca solide, dhe jo organizatë joqeveritare, siç parashihet nga autoritetet e Kosovës. Ai ka thënë se serbët në veri nuk do të heqin dorë nga institucionet e mbetura paralele “pa pasur një Asociacion i cili ka përgjegjësi të fuqishme”. Ai ka shtuar se Kosova duhet ta amandamentojë kushtetutën e saj për ta akomoduar Asociacionin. Folësit e Kosovës kanë refuzuar këtë ide dhe kanë thënë se Asociacioni duhet t'i përshtatet kushtetutës së Kosovës, e jo anasjelltas. “Nëse është aq e lehtë të ndryshohet kushtetuta, atëherë pse nuk e ndryshon Serbia kushtetutën e saj?” ka thënë njëri nga folësit.

Kosova tashmë ka hequr dorë mjaft në procesin e dialogut, ka thënë një tjetër folës nga Kosova. Ai ka thënë se marrëveshja e Brukselit është në kundërshtim me kushtetutën e Kosovës, por zyrtarët e Kosovës janë pajtuar me të si rezultat i trysnisë ndërkombëtare. Krijimi i shtresave të reja të institucioneve nuk e përmirëson jetën e serbëve në Kosovë. “Serbët në Kosovë nuk

mërziten fort për krijimin e institucioneve të reja kur shohin se nuk ka kurrfarë përmirësimi në terren dhe janë çdo ditë e më të varfër”. Për më shumë, krijimi i Asociacionit është i bazuar në parimin e segregimit dhe promovon ndarje, pasi që përfshin vetëm komunat me shumicë serbe. Tani do të jenë dy asociacione të komunave, njëra e komunave me shumicë shqiptare, dhe tjetra e komunave me shumicë serbe. “Nuk ekziston ndonjë term tjetër për këtë gjë përveç segregimit”, ka thënë ky folës. Ai poashtu ka thënë se si Prishtina, ashtu edhe Beogradi kanë draft-statutet e tyre për Asociacionin, porse ende askush nuk i ka parë ato.

Ligjet dhe kushtetuta e Kosovës nuk do të ndryshohen, ka theksuar ky folës. Asociacioni do të duhej të krijohej përbrenda legjislacionit ekzistues dhe nuk do të jetë organ qeveritar. Folësi ka fajësuar serbët për vonimin e implementimit të marrëveshjes në njërën anë, dhe në anën tjetër për vendosjen e afateve kohore për krijimin e Asociacionit, duke u munduar kështu “ti shantazhojnë institucionet e Kosovës”. Ai ka thënë se ekziston një marrëveshje rreth gjykatave në veri, por ende as nuk ka filluar të implementohet. Forcat paralele të sigurisë, të njohura si mbrojtja civile janë ende aty dhe Beogradi vazhdon ti financojë ato, si dhe strukturat tjera paralele në veri, roli i të cilave është “minimi i shtetit të Kosovës”.

Një folës serb nga Kosova ka thënë se tema kryesore e marrëveshjes së Brukselit ka qenë Asociacioni i komunave me shumicë serbe, por sot e kësaj dite, Prishtina dhe Beogradi nuk kanë dhënë asnjë propozim. Beogradi duket se nuk është duke punuar aspak në këtë drejtim, kurse Prishtina ka formuar një ekip prej katër personash që nuk kanë bërë ende asgjë. Ai ka thënë se Asociacioni duhet të jetë përgjegjës për arsimin dhe shëndetësinë, fusha këto të cilat për momentin administrohen nga Beogradi. Megjithate, në baze të ligjeve të Kosovë, këto fusha bëjnë pjesë në kompetencat komunale. Ai ka konkluduar se Asociacioni do të bëhet organ politik, dhe jo organizatë joqeveritare, siç është Asociacioni ekzistues i Komunave. Një folës nga Kosova ka thënë se thelbi i debatit mbi Asociacionin është se serbët frikësohen nga diskriminimi që mund t’u bëhet atyre në Kosovë, kurse kosovarët i frikësohen një shteti jofunksional.

Përkundër shumë sesioneve të dialogut në Bruksel dhe një numri marrëveshjesh, jetërat e njerëzve nuk janë përmirësuar, dhe ky është shkaku pse dialogu shihet si i padobishëm. Dhe perceptimet janë të rëndësishme pasi ato shëndrohen në veprime. “Ne të gjithë themi se viti i kaluar ka qenë i suksesshëm në marrëdhëniet mes Kosovë e Serbisë, por ky sukses nuk i ka prekur njerëzit”, ka thënë një folës i cili e njih për së afërmi procesin e implementimit. Ai ka shtuar se ministri i ri në krye të qeverisjes lokale në Kosovë është njëri nga akterët kryesorë, dhe se ai duhet të të jetë konstruktiv dhe efikas në lidhje me ndërtimin e institucioneve në veri.

“Përkundër kritikave të mia të vazhdueshme, unë e mbështes dialogun sepse ai është i vetmi mekanizëm për zgjidhjen e problemeve të pazgjidhura me Serbinë”, ka thënë një folës nga Kosova. Megjithate, ai nuk do ta përkrahë ate nëse dialogu shkel rendin kushtetues të Kosovës. Ai ka raportuar se legjislacioni i Kosovës njih organe qeveritare dhe joqeveritare, por nuk ka mundësi që Asociacioni të mos jetë as njëra e as tjetra. Ai u ka bërë thirrje kolegëve të tij serbë të shpjegojnë se çfare kompetenca duan ata për Asociacionin, e që tashmë nuk i kanë komunat, dhe poashtu ka shpjeguar se transferi i fuqisë nga komunat në një tjetër organ është ilegal, dhe si i tillë nuk do të miratohej nga autoritetet e Kosovës. “Ne nuk mund të ndryshojmë kushtetutën dhe ligjet tona sa herë që kjo u teket serbëve dhe Beogradit”.

Një folës nga Kosova ka thënë se Asociacioni duhet të ketë vetëm rol mbikqyrës. Në lidhje me largimin eventual nga puna të qindra të punësuarve në institucionet e stërmbushura paralele, ai

ka propozuar që Beogradi t'i subvencionojë ata të cilët do të duhet të largohen nga puna në veri. Ai ka qenë kundër idesë që Asociacioni t'ua shpërndajë pagesat këtyre personave. Ai poashtu ka thënë se komunat duhet ti paguajnë mësuesit dhe mjekët. “Është e rrezikshme ti lihet Asociacionit kontrolli i drejtpërdrejt mbi mijëra të punësuar”. Ky folës ka thënë se Asociacioni do të ketë një rol më të fuqishëm se këshillat ekzistues të minoriteteve në Serbi. Një tjetër folës ka shtuar se nëse Beogradi dëshiron të tregojë se çfarë qëllimi dëshiron të arrijë me Asociacionin, atëherë le ta tregojë këtë më një shembull, duke u dhënë të njëjtat të drejta shqiptarëve në jug të Serbisë dhe minoriteteve tjera në pjesë tjera të Serbisë.

Një folës ka theksuar se Beogradi dëshiron që Asociacioni të bëhet shtresa e tretë e qeverisë, dhe ka shtuar se “kur ke kontroll mbi çeshtjet financiare, atëherë je organ qeveritar”. Decentralizimi do të duhej të ishte i mjaftueshëm për të akomoduar serbët në Kosovë. Sa i përket përfaqësimit politik, ai ka shtuar se Lista Srpska nuk i përfaqëson serbët në Kosovë, por ata në Beograd. “Srpska nuk e ka pasur as edhe një takim të vetëm me serbët e Kosovës. Përfaqësuesit e saj gjithmonë shkojnë në Beograd për konsultime. Rrjedhimisht, Asociacioni nuk do t'i përfaqësojë serbët e Kosovës, por Beogradin”. Ai ka thënë se interesat e Beogradit dhe serbëve të Kosovës nuk janë gjithmonë të njëjta. Ky folës ka kërkuar që të flitet për të gjithë qytetarët e Kosovës, jo vetëm për serbët. “Ne flasim se si ta zgjidhim çështjen e papunësisë në mesin e serbëve, por jo edhe në mesin e komuniteteve të cilat kanë edhe më shumë papunësi”. Ai ka shtuar se edhe nëse Kosova i ndryshon ligjet e saj dhe kushtetutën, “një gjë e tillë nuk do të përmirësojë integrimin e serbëve të Kosovës, por thjesht do të legalizojë një mekanizëm serb të ndërhyrjes në sistemin e Kosovës”.

Duke u pergjigjur në pyetjen se pse serbët janë kundër planit të Ahtisarit, por janë pro marrëveshjes së Brukselit, një folës serb ka thënë se kjo e fundit është neutrale ndaj statusit. Megjithate, një tjetër folës nuk është pajtuar më këtë, duke thënë se marrëveshja është e bazuar në sistemin e Kosovës dhe se ajo ka qenë justifikimi i Beogradit për të pranuar përfundimisht pakon e Ahtisarit. Ai ka shtuar se parakushtet për krijimin e Asociacionit janë largimi i strukturave paralele dhe funksionimi i sistemit ligjor të Kosovës në veri. Megjithate, një folës i afërt me punën e strukturave paralele ka thënë se “strukturat paralele, siç janë mbrojtja civile, nuk janë kërcënim për askend; përkundrazi, ato janë asete për veriun”. Një numër i folësve serbë janë fokusuar në punësimin e atyre që do të humbin vendet e punës në momentin kur të mbyllen institucionet paralele, dhe kanë folur për përgjegjësinë e shtetit për qytetarët. Një folës serb ka thënë se atyre u duhen diskutime shtesë në Bruksel rreth fatit të rreth 2,000 të punësuarve, të cilat sipas të gjitha gjasave, pas integritimit do t'i humbin vendet e tyre të punës.

Përkundër shumë mosmarrëveshjeve rreth mandatit të Asociacionit, ka ekzistuar një pajtim i gjërë se krijimi i Asociacionit dhe shuarja graduale e strukturave paralele do të jenë procese paralele.

E ardhmja e dialogut

Politikisht, Kosova dhe Serbia janë në një moment të mirë për të vazhduar normalizimin e marrëdhënieve, pasi që të dyja kanë qeveri të fuqishme dhe dëshirë politike për të përmirësuar marrëdhëniet. Megjithate, nga ana ekonomike, që të dyja përballen me nivel të lartë të papunësisë, me pak ose aspak rritje ekonomike, nivele të larta të korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe shumë pak investime. Duke marrë parasysh këto vështirësi dhe gjendjen sfiduese në të cilën gjenden të dyja vendet, një folës ka thënë se “është e vështirë të normalizohen marrëdhëniet mes

dy shteteve jonormale”. Ky folës ka thënë se Kosova dhe Serbia duhet të fokusohen më shumë në çështjet ekonomike, dhe në të njëjtën kohë të fuqizojnë stabilitetin politik. Ajo ka thënë se “edhe pse Bashkimi Evropian nuk është në gjendjen më të mirë, nëse mbesim jashtë tij do të ishte një fatkeqësi”. “Ne të gjithë kemi nevojë për një qasje më serioze afatgjate, por një gjë e tillë nuk ekziston!”, ka thënë ajo. “Ne duhet të komunikojmë me qytetarët tane. Kjo do të ishte një shenjë e vërtetë e lidhshimit. Njerëzit mund të gëlltisnin mjaft nëse komunikoni me ta”.

Përkundër një progresi solid, një numër folësish kanë theksuar se marrëdhëniet mes Kosovës e Serbisë janë larg prej të qenit të normalizuara. Një folës ka thënë se dialogu është një gjë e mirë, por fakti që duhet aq shumë kohë që të ketë pajtim për detajet edhe më të vogla, tregon se dy vendet ende nuk janë të gatshme për normalizim të plotë të marrëdhënieve. Ai ka thënë se dialogu duhet të përfundojë në një pikë dhe të prodhojë rezultate të prekshme për popullin. Ai ka shprehur se interesat e përbashkëta e shteteve të Ballkanit, e posaçërisht dëshira për t’iu bashkuar Bashkimit Evropian, do të çonin drejt rritjes së bashkëpunimit dhe përshejtimit të procesit.

Folësit e Kosovës, duke përfshirë ata të cilët mbështesin dialogun, kanë qenë më kritik ndaj këtij procesi. Një folës ka thënë se dialogu në këtë formë nuk duhet të vazhdojë, pasi që nga ai përfiton pikësepari Serbia. “Serbia është bërë kandidat i BE-së, përderisa Kosova as që ka integruar komunitetin e tij serb në veri, që ka qenë qëllimi i dialogut”. Ai për më shumë ka thënë se vetë serbët janë viktimë e Beogradit, i cili i shfrytëzon ata si “kartë për progresin e Serbisë drejt BE-së”.

“Të gjithë kanë dështuar në veri. Ne jemi pajtuar rreth integritetit por jo rreth planit të veprimit, dhe kjo është e keqja e marrëveshjes”, ka thënë një folës serb. Përvoja me integrimin e policisë në veri ka qenë shumë pozitive. Beogradi dhe Prishtina kanë negociuar për më shumë se tre muaj, por në fund çdo zyrtar policor e ka ditur se ku do të jetë ai/ajo. I njëjti proces negociimi është i nevojshëm në lidhje me strukturat e mbetura në veri. Ky folës ka thënë se njerëzit të cilët punojnë në institucione të ndryshme kanë nevojë ta dinë se çfarë do të ndodhë me ta pas implementimit të marrëveshjes. Çështja e mbrojtjes civile mbetet çështje kontraverse. Për serbët, mbrojtja civile është një aset, kurse për shqiptarët paraqet kërcënim për sigurinë. Ky folës ka shtuar se mbrojtja civile nuk është kërcënim, por thjesht “grup që i japin vetes të drejtën e marrjes së pushtetit në duart e tyre”, duke qenë se sundimi i ligjit në veri është i dobët. Ai ka thënë se sfida kryesore e tranzicionit në veri është mbetja potenciale pa punë e atyre që për momentin punojnë në institucionet paralele. Financimi i shtetit serb është duke u bërë poashtu problematik. “Serbia më nuk mund të financojë institucionet paralele në Kosovë, siç janë komunat, apo Asociacioni, kurdo që ai të krijohet”.

Pjesëmarrësit poashtu kanë inkurajuar rritjen e bashkëpunimit bilateral mes institucioneve të Kosovës dhe Serbisë. Ata kanë definuar fushën e sigurisë, ambientit, bashkëpunimit parlamentar, kulturës, mediave dhe sportit si fusha në të cilat Prishtina dhe Beogradi do të duhej të fillonin bashkëpunimin. Pjesëmarrësit kanë thënë se me vendosjen e një niveli të caktuar të normalizimit, Beogradi dhe Prishtina do të duhej të bashkëpunonin më shumë në luftimin e krimit të organizuar dhe promovimin e zhvillimit ekonomik, si dhe rreth integriteteve evropiane. Rritja e bashkëpunimit për çështjen e personave të zhdukur është konsideruar si kyçe për normalizimin e marrëdhënieve mes dy shoqërive. Pjesëmarrësit kanë thënë se vizitat e fundit të ministrave të Kosovës në Beograd janë një tjetër tregues se normalizimi i marrëdhënieve mes Kosovës e Serbisë është duke levizur në drejtimin e duhur.

Si pjesë e normalizimit të marrëdhënieve, poashtu duhet të bëhet “kërkimfalja nga Serbia për krimet e kryera në Kosovë, në të njëjtën mënyrë siç është bërë edhe ndaj Bosnje e Hercegovinës për gjenocidin e Srebrenicës”, ka thënë njëri nga folësit nga Kosova. Një tjetër folës serb nuk e ka përjashtuar mundësinë që një kërkimfalje nga ana e Beogradit të ndodhë në një të ardhme të afërt, por ka thënë se kërkimfaljet shtetërore janë të ndjeshme dhe se nevojitet më shumë përgatitje për t’u bërë një gjë e tillë. Ai ka shtuar se Serbia është duke punuar në gjetjen dhe dënimin e kryesve të krimeve.

Përfundim

Ne vitin 2013 në Bruksel, Prishtina dhe Beogradi janë pajtuar rreth krijimit të Asociacionit të komunave me shumicë serbe, por jo edhe për mandatin e tij. Përfaqësuesit e Kosovës kanë thënë se Asociacioni do të duhej të shërbente si një organizatë joqeveritare për koordinimin e bashkëpunimit mes komunave me shumicë serbe. Përfaqësuesit serbë, në anën tjetër, presin që Asociacioni të jetë organ politik me autoritet solid mbi arsimin, shëndetësinë, planifikimin urban, dhe privatizimin në të gjitha komunat me shumicë serbe. Kërkesat e mëhershme të tyre që Asociacioni të zgjedhet me votë të drejtpërdrejt nga populli dhe të ketë autoritet mbi policinë dhe gjykatat, janë hedhur poshtë gjatë dialogut të Brukselit. Së këndejmi, zyrtarët policorë janë integruar në Policinë e Kosovës dhe një marrëveshje rreth integritit të gjykatave në sistemin e Kosovës është arritur, edhe pse ende nuk është implementuar.

Duke pasë parasysh këto pritje të kundërta me njëra tjetrën, të shqiptarëve dhe serbëve – organizatë joqeveritare apo organ autonom politik – procesi i negociimit rreth Asociacionit do të jetë i vështirë, por shumë prej akterëve presin që do të ketë marrëveshje në pjesën e parë të vitit 2015.

Mosmarrëveshja kryesore rreth krijimit të Asociacionit është nëse i njëjti duhet të formohet para apo pas shpërbërjes së strukturave të mbetura paralele në veri. Zyrtarët e Kosovës thonë se strukturat paralele do të duhej të mbylleshin para krijimit të Asociacionit, kurse përfaqësuesit serbë thonë se së pari duhet të vjen Asociacioni, e pastaj mbyllja e strukturave paralele. Sipas të gjitha gjasave, procesi do të jetë paralel.

Sa i përket dialogut, ka ekzistuar një pajtim i gjërë që dialogu duhet të vazhdojë dhe marrëveshjet duhet të implementohen. Pjesëmarrësit kanë thënë se Prishtina dhe Beogradi do të duhej ta zgjeronin dialogun dhe bashkëpunimin edhe në çështjet e ambientit, drejtësisë dhe sundimit të ligjit, vlerësimin e kërcënimeve ndaj sigurisë së Kosovës e Serbisë, dhe se vizitat e zyrtarëve të Kosovës në Beograd dhe vizitat e zyrtarëve të Serbisë në Kosovë do të duhej të ishin më të shpeshta.

Pjesëmarrësit

Illir Deda, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje
Nenad Djurdjevic, Koordinator, Forumi për Marrëdhënie Etnike
Marko Djuric, Drejtor i Zyrës për Kosovë e Metohi, Qeveria e Serbisë
Nikola Eric, Anëtar, Këshili për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Partia Progressive Serbe
Sadri Ferati, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës
Ardian Gjini, Zëvendëskryesues, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
Bosko Jaksic, Kolumnist, Beograd
Adriatik Kelmendi, Kryeredaktor, KTV Kohavision
Vladeta Kostic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Progressive Serbe
Sonja Licht, Presidente, Fondi i Beogradit për Ekselencë Politike
Leon Malazogu, Drejtor Ekzekutiv, Instituti Demokraci për Zhvillim
Ljubisa Mijacic, Analist, Zubin Potok
Jugoslav Milacic, Këshilltar i Ministrit pa portofol në Qeverinë e Serbisë përgjegjës për Integrimet Evropiane
Petar Miletic, Ish-nënkryetar i Parlamentit të Kosovës
Dardan Molliqaj, Sekretar Organizativ, Lëvizja Vetëvendosje
Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal
Krstimir Pantic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Progressive Serbe
Gazmir Rraci, Këshilltar i Ministres pa portofol në Qeverinë e Kosovës përgjegjëse për dialogun me Serbinë
Dejan Radenkovic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Socialiste e Serbisë
Nenad Radosavljevic, Kryesues i Bordit, Rrjeti i Pavarur i TV stacioneve serbe në Kosovë
Naim Rashiti, Drejtor i Projektit, Grupi i Ballkanit
Besa Shahini, Analiste e Lartë, Iniciativa Evropiane për Stabilitet
Predrag Simic, Profesor, Universiteti i Beogradit
Dragan Sormaz, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Progressive Serbe
Janko Veselinovic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Social-Demokrate
Arber Vllahu, Shef i Kabinetit të Presidentes së Kosovës
Shpetim Gashi, Nënpresident, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Alex Grigorev, President, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Boyd Mckechnie, Këshilltar i Lartë mbi Çështjet Politike të Përfaqësuesit Special të BE-së në Kosovë; Koordinator i dialogut në veri
Igor Novakovic, Bashkëpunëtor në Serbi, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Jean-Daniel Ruch, Ambasador i Zvicrrës në Serbi
Saskia Salzmann, Këshilltare e Sigurisë Njerëzore, Ambasada e Zvicrrës në Kosovë
Talia Wohl, Zyrtare e Programit, Departamenti Federal për Punë të Jashtme të Zvicrrës